



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



02 Nr. 060/04-29968 dt. 22.06 2023

PROCESVERBALI

I mbledhjes se rregullt të Kuvendit Komunal të Drenasit të Mbajtur më datë: **26.05.2023** e cila vazhdoi me dt. **31.05.2023**.

Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit Komunal-Milaim Hajdari

Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal, ku të pranishëm ishin 31 anëtarë: Labinot Halilaj (PDK), Bekim Lestrani (PDK), Arigon Sinani (PDK), Zeqir Hasi (PDK), Laurita Muhadri Bujupi (PDK), Hamit Kastrati (PDK), Blerina Gashi (PDK), Gani Krasniqi (PDK), Fatmir Baliu (PDK), Qendrim Mulaj (PDK), Malsore Cakiqi (PDK), Blerina Gashi (PDK), Albulena Saliuku (PDK), Valentina Leku (PDK), Sali Dvorani (DD) Mergim Pirraku (DD), Mehedin Salihu (DD), Hamit Haxhiu (DD), Jahir Hajdari (DD), Azemine Bujupi-Gjoka (DD), Marigona Bazaj (DD), Florentin Elezi-Veliu (VV), Filloreta Bujupi (VV), Drin Halilaj (VV), Egzona Terdevci (VV), Muhamet Kurtaj (VV), Arbër Halilaj (GREEN), Beqir Kiqina (AAK), Egzon Qorri (LDK). Ndërsa në vazhdimin e mbledhjes me dt. 31.05.2023 mungoi Sali Dvorani, Mirlinda Dvorani.

Kuvendi filloi punimet më këtë :

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal Drenas i mbajtur më dt. **20.04.2023**.
2. Propozim vendim për shfuqizimin e vendimit 02 Nr.400/01-14929 të datës 28.03.2023, të Kuvendit të Komunës së Drenasit.
3. Propozim vendim për miratimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për Qendrën e Qytetit Gllogoc.
4. Propozim vendim për kompensimin e anëtarëve të Komisionit për zgjedhjen e kryetarëve dhe këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane në Komunën e Drenasit.
5. Propozim vendim për rialokim të mjeteve financiare nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.
6. Propozim vendim për rritjen dhe bartjen e të hyrave Vetanake.
7. Propozim vendim për rialokim të mjeteve financiare nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.
8. Propozim vendim për miratimin e kërkesës. Nr. 01-070/01-0023340/23, 17.5.2025, për ndihmë financiare për mjekim urgjent të sëmundjes – kancer ovarian, në shumën totale prej 3,000.00 euro.
9. Të ndryshme.

Mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Drenasit u mbajt të premten me dt. 26.05.2023 dhe vazhdoi me dt. 31.05.2023 po me të njëjta pika të rendit të ditës, ku për diskutim ishin 9 pika për rend dite. Mbledhja është kryesuar nga kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari.

Në mbledhje morën pjesë, Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci, nënkryetari Arben Shala, përfaqësues të KFOR-it, drejtor të drejtorive komunale, zyra e informimit, qytetar.

Më poshtë ju elaborojmë pikat që janë diskutuar e miratuar me shumicë votash në mbledhjen e rregullt të Kuvendit të Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit njoftoi me rendin e ditës anëtarët e Kuvendit Komunal.

Florentina Elezi-Veliu, Ne komitetin për politike dhe financa, kam ngritur një çështje mjaft të rëndësishme për qytetaret e Drenasit, e ne veçanti fëmijët, e propozova si rend te ditës subvencionimin prej 30% për fëmijët që ndjekin kopshtet private ne Komunën e Drenasit.

Duke e parë rëndësinë e edukimit të hershem, i cili luan rol kyç në zhvillimin dhe formësimin e personalitetit të fëmijëve, kjo e drejte duhet të jetë e barabarte për të gjithë fëmijët e komunës sonë, e për të lehtësuar barrën e prindërve meqë kopshtet private tashme po kane një kosto, që nuk është lehtë e përballueshme për të gjithë, dhe mungesa e theksuar e kopshteve publike, propozoj që të subvencionojmë vijimin e fëmijëve në kopshte private prej 30%, për familje që kanë të ardhura nen 400 euro.

Financimin e iniciativave të tilla e parasheh edhe ligji mbi edukimin parashkollor neni 27. Prandaj, kërkoj mbështetje nga koleget asamblist, që ta përkrahin këtë pike të rendit të ditës.

Shyqiri Bublatku-Drejtor i Financave, ne e kemi cek se nuk financojmë firmat private, gjegjësisht çerdhet private, jo fëmijët dhe prindërit.

Albulena Saliuki, nga përvoja të cilën e kam si menaxhere administrative në po të njëjtin institucion, mendoj se institucionet private nuk mundën me u financu përveç nëse është publiko-private.

Arbër Halilaj, siç është e rëndësishme edukimi i parashkolloreve i fëmijëve, këtë çështje e kanë ngrit edhe në KPF-ca Florentina Elezi nga VV, pavarësisht kush ngrit çështje të tilla në princip ne jemi që të zbatohen konventat për të drejtat e fëmijëve dhe të drejtat e tjera që i mbrojnë të drejtën e shkollimit parashkollor dhe gjithashtu bazuar ne nenin 27 ku thotë MASHT-i dhe institucioni janë përgjegjëse komunale të edukimin parashkollor do të synojnë përkrahjen financiarisht iniciativat jo publike private që ofrojnë shërbimet e edukimit parashkollor, po ashtu ceket që gjatë marrjes në konsideratë të përkrahjes financiare të këtyre iniciativave duhet të ketë parasysh këto kritere: pozita gjeografike e komunitetit ku ofrohet ky shërbim duke marrë parasysh sidomos zonat rurale të lëna pas dore, shërbimet për fëmijë më nevoja të veqanta personeli, institucioni do të jetë i punësuar në baza të rregullta ligjore, qasja tjetër e hapur për të gjithë fëmijët, dmth që qelimi është që sa ma shumë fëmijë do të kyqen në këto institucione dhe kishe qenë mirë të debatohet si pikë e rendit, jam që të hyje kjo pikë në rendin e idtës si diskutim.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, sa i përket pikës që e ka ngrit znj. Elezi mendoj që nëse ju e shihni si të arsyeshme me e fut në rend ditë piken e propozuar nga znj. Elezi për ta debatuar ne mund të debatojmë por ligji nuk na lejon me financu çerdhet private, ne duhet me specifiku ma sakt subvencionimin individual të prindërve ne mund ta zgjidhim por me i financu çerdhet private ne nuk kemi të drejt, ne mund t'i subvencionojmë si familje nëse kane pagë deri në 400 euro bashkërisht ne mund t'i subvencionojmë apo të votoni ju sepse është në dorën tuaj.

Mehedin Salihu, e përkrahi iden e koleges se ma sa kam informacione i kanë disa lirime për disa kategori kurse në çerdhet private nuk ekziston një gjë e tillë. Jam për me i liru dhe me iu ndihmu.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, ne nuk e cekem që kena me ia hek apo diçka, këna me i subvencionua, subvencionimi mund të jetë 50-100-200 € por jo me ia subvencionua çerdhen dikuj që ka pagë 400 euro.

Meqë nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime tjera kryesuesi hodhi në votim propozimin e Florentina Elezit, Subvencionimi i fëmijëve që vijnë në kopshtet private në Komunën e Drenasit, për fëmijët me të ardhura nën 400 € në muaj, prezent gjatë votimit ishin 31 anëtar, (Për) votuan 30 anëtar, kundër nuk pati, 1 abstenim, u miratua kjo pikë e rendit të ditës që të hyjë në rend dite.

Meqë nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime tjera kryesuesi hodhi në votim rendin e ditës: prezent gjatë votimit ishin 31 anëtar, (Për) votuan 31 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati, u miratua rendi i ditës se bashku me propozimin e Florentina Elezit e cila u votua në mënyrë unanime nga asambleja komunale që të hyj në rend dite.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës: **1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt i Kuvendit Komunal Drenas të dt. 20.04.2023**

Meqë nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime tjera kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 31 anëtar, (Për) votuan 31 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati, u miratua kjo pikë e rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e dytë të rendit të ditës: **2. Propozim vendim për shfuqizimin e vendimit 02 Nr.400/01-14929 të datës 28.03.2023, të Kuvendit të Komunës së Drenasit.**

Arbër Halilaj, lidhur me kërkesën për shfuqizimin të këtij vendimi që kemi diskutuar edhe në Komitet për Politikë dhe Fincanca, natyrisht kur të vjen prej MAPL-së vetëm duhet ta miratojmë se është qeshtje procedurale, mirëpo kërkoj që të insistohet meqë edhe fizibiliteti e ka deshmë që propozimi i tretë është ai i duhuri për ngrohtoren e qytetit të insistohet edhe nga komuna tek ministria përkatëse dhe subjektet tjera të involvuar që ky projekt të shtyhet përpara me mundësinë e ndërrimit të hipotekave meqë lejohet të jepet një hipoteke tjetër në vlerë të njëjtë dhe vazhdohet me të njëjtin projekt me të njëjtin opsion, me të njëjtin projekt.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, ne e kemi diskutuar dhe vet na kërkuar anëtarët e Ministrisë që janë në këtë komision dhe e kanë ditë që është hipoteke pra kerkush nuk ka thënë që nuk është në hipoteke por ata e kane kërkuar dhe në fund të vitit del prej hipotekës si pronë, ne po presim më na dhënë një propozim tjetër ose me na thënë çka me vendos ma

tutje, nuk besoj që fizibilitetit i ngrohtores së qytetit ka me u shmang ose ka me u hek, ne me qëllimin ma të mirë e kemi votu, dhe MAPL-ja e ka kthi, ka të drejt mirëpo ka të drejt plotësisht se pronat qe janë në hipotekë nuk mund të këmbehen mirëpo vet anëtarët e BERZH-it na kanë thënë propozonë këtë sepse kjo është pozita ma e mirë.

Meqë nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime tjera kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 31 anëtar, **(Për)** votuan 31 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati, u miratua kjo pikë e rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e tretë të rendit të ditës: **3. Propozim vendim për miratimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për Qendrën e Qytetit Glllogoc.**

Egzona Tërdevci, pyeti: nga faqe 69 tek plani që na është dërgu në versionin elektronik janë të paraparë tre skenar se si planifikohet me u bë rregullimi i hollësishëm i qendrës së qytetit, vetëm skenari i parë e parashe sheshin që është aktualisht ndërsa dy skenarët e tjerë e parashohin sheshin e zgjeruar, në situatë hipotetike kur nuk është e mundur realizimi i zgjerimit të sheshit a keni me shku vetëm me versionin e parë apo behet mandej një modifikim i planit?

Arbër Halilaj,

Plani Rregullues i Hollësishëm “Qendra Drenas” derivon nga HartaZonale Komunale (HZK) të cilën eka miratuar kjo asamble, ndërsa unë kam votuar kundër për arsyet e cekura atëherë.

Plani Rregullues i Hollësishëm është dokument i rëndësishëm që përcakton kahet apo drejtiet e zhvillimit, tendencave, mundësive dhe rreziqeve sa i përket zhvillimore urbane të Qendrës Drenas. Për këtë arsye, nëmbledhjen eKPF kam kërkuar raport të detajuar lidhur me ecurinë e procesit të hartimit të Planit, dëgjimet me qytetarë të mbajtura për këtëPlan, sygjerimet dhe kërkesat e tyre, si dhe implementimin apo involvimin e këtyre kërkesave pasta j në Plan, meqë ky plan do t’ishërbejë interesave të qytetarëve dhe të zhvillimit të Drenasit. Këtë raport të detajuar e informues si zakonisht e kemi marrë me shumëvonesë dmth.: dytri ditë para kësaj séance, që duke pasur parasyshrëndësinë e planit, është e patolerueshme. Nuk shoh që është bërë ta zëmë. Në komunat tjera projektuesit kanë bërë edhe anketime tëpopullatës së Qendrës për hulumtimin e çështjeve demografike, socialeekonomike, fizike, mjedisore etj. si dhe pastaj përpunimin e atyretë dhënave që kanë dalë nga këto anketime, si dhe konkluzionet. Ajo çfarë unë pajtohem me konstatimet ePRRH. Është se Feronikeliështë super ndotësi i Drenasit, që e kemi cekë gjithmonë edhe ne siGREEN, ku parashihet aplikimi i parimit që në kemi në program dmth. “ndotësi pagan”. Parashihet zgjerimi i arterieve kryesore rrugore, qëedhe ky mendoj se është synim i duhur. Konstatohet se duhet mbrojturrjeti ekologjik në Zonën Urbane si dhe biodiversiteti i lumit Drenica, ndërsa aty nuk ka çka të mbrohet, sepse është biodiversiteti i shkatërruar. Zonat e gjelbëruara dhe sheshet konstatohet se janë më se tëmjafueshme në Drenas, për kokë banori. Nëse merret pra m2/kokëbanori del se ka 1500 e sa m2 sheshe dhe gjelbërim më tepër, prandaj nuk arsyetohet insistimi apo prioriteti për zgjerimin e sheshit që ështëpërfshirë edhe në këtë PRRH.

Shihet që mungon involvimi i qytetarëve dhe i prioritetëve të tyre, që do të dilnin nga dëgjimet publike të organizuara mirë e jo sa për sy e faqe, me zyrtarë komunal apo me ndërtues dhe sa për të thënë që janë mbajtur.

Sa qytetarë janë anketuar, sa njësi individuale dhe kolektive banimi, sabiznese janë vizituar dhe anketuar në kuadër të këtij PRRH.

Këtu ishtedashur ndoshta të ishte prezent edhe përfaqësuesi i projektuesit që të najep më shumë detaje që na mungojnë. Deri në versionin final që na u ka dërguar para 2-

3 dite, kanë munguar pjesë të rëndësishme dmth.: kushtet e ndërtimit, infrastruktura teknike, e transportit etj. Për shkak të këtij raporti informues dhe më të detajuar që është i vonuar, mbi rrjedhën e hartimit të PRRH, i cili del nga HZK, për të cilën edhe më tej nuk kam pasur informacione shtesë, por për shkak edhe të mosinvolvimit të duhur të qytetarëve dhe kërkesave të tyre në këtë plan, i cili lë pa zgjidhur disa çështje të rëndësishme, si dhe duke pasur parasysh që ky plando të jetë në tërësi bartës i interesave zhvillimore të qytetarëve të Drenasit, unë për shkak të këtyre mangësive do ta votoj kundër.

Azmine Gjoka, sa i përket pikës propozim vendim për miratimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për Qendrën e Qytetit Glllogoc, neve na mungon materiali shtesë i mjaftueshëm për këtë pikë të rendit të ditës për kundër asaj që na është premtu që do të na sjellë materialin me kohë dhe fizikisht, mungojnë informacionet e hollësishme të diskutimit publik, komentet shqetësime të qytetarëve gjatë diskutimit publik për miratimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për Qendrën e Qytetit, punën 30 ditëshe të diskutimit publik e keni të përmbledhur 3 rreshta arsytim prandaj kjo shihet qartë një jo profesionalizëm ndaj shërbimeve të qytetarëve prandaj pikërisht për këtë arsye jemi kundër votimit të kësaj pike.

Flutura Avdiu-Drejtoreshë e Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit, para vetes e keni një propozim vendim për hartimin e planit rregullues të hollësishëm, me miratimin e Hartës Zonale pra është përcaktuar që përmes Hartës Zonale të fillohet me hartimin e planit rregullues të hollësishëm, kështu do të përcaktohen kushtet për rregullimin e hapësirave për zonën urbane rurale ashtu siq është përcaktuar me planin zhvillimor komunal dhe hartën zonale, zona që do të hartohet ky plan është kryesisht zona e qendrës së qytetit, që përfshinë një sipërfaqe prej 110 Ha, Plani rregullues i qytetit do të mbulojë një periudhë se paku 8 vjeçare ku është në harmoni të plotë me ligjin për planifikimin hapësinor, kryesisht këtë vit kemi filluar me qendrën e qytetit ndërsa në vitet në vijim e kemi zonën në Komoran po ashtu edhe vendbanimet jo formale në lagjen e feronikelit. Sa i përket pyetjes që e parashtruat, në faqen 69 parashihen skenarët në të cilat planifikohen kryesisht e kemi obligim ligjor të prezantojmë tre skenar, Komuna e Drenasit ka vendosur vetëm një prej skenarëve për zgjidhje ku tre janë obligim ligjor që të bëhet zgjidhja nga kompania të cilën e këna hartuar dhe ne rastin tonë është zgjedh skenari tretë për implementim. Plani rregullues është vetëm një planifikim, projekti a implemetohet apo nuk implemetohet nuk varet në planin rregullues ne vetëm planifikojmë që të ardhmën të planifikohet për një periudhë të vjeçare sepse po mos të planifikohet ai plan nuk mund të implementohet sepse është një dokument i planifikimit hapësinor, projekti i sheshit ekzekutohet ndërsa plani rregullues vetëm parashih planifikimin. Ndërsa përgjigja nga asambleistja e DD komentet të cilat i keni theksuar se nuk janë inkuorporuar ose nuk i keni parë në raportin e shqyrtimit publik kur i kemi dërguar materialet, është edhe një dokument tjetër ku është raporti i shqyrtimit publik ku në faqe të fundit i keni të gjitha komentet që i kemi pranuar gjithsej 14 dhe të gjitha ju kemi kthyer përgjigje a janë aprovuar apo jo dhe të gjitha përgjithet në formë tabelare.

Azmine Gjoka, e paraparë me rregullore është 7 ditë më herët me na dërgu materialin dhe një pikë kaq e rëndësishme për qytetin e Drenasit dhe një material kogja voluminoz dhe nuk kemi pas mundësi me e shqyrtu këtë material voluminoz, kërkoj që të jetë me e qartë gjithqka.

Hamit Haxhiu, pajtohem me kolegen ne nuk kemi pranuar asnjë material rreth kësaj pike te rendit të ditës dhe ne nuk mundemi me diskutu për një diçka që ne nuk e kemi, dhe na duhet pak kohë për me shqyrtu dhe për këtë arsyeje jemi kundër kësaj pike.

Arbër Halilaj, materiali ka ardh material me 23 maj në ora 10:52 min dmth dy ditë para seancës.

Beqir Kiqina, po e shoh që të gjithë asambleja po hezitojmë rreth kësaj pikë që ka të bëjë me zgjerimin e sheshit, zgjerimi i sheshit nënkupton zhvillim ekonomik, nënkupton tërheqjen e investitorëve, nënkupton qarkullim të bizneseve, dhe nënkupton respektim të figurave te shquara të shtatoreve të cilat gjenden sot në sheshin tonë.

Floretina Elezi-Veliu, mjaft me i përdoret heronjtë, ushtaret, komandantat njerëzit që kanë dhënë jetën për liri mjaft i përdoret për interesa banale, kjo është absurde për mijëra e qindra fëmijë që nuk i kanë prindërit që e kanë dhënë jetën ne luftë, dhe çka votojmë këtu nuk ka kurgja të bëjë më njerëzit që e kanë dhënë jetën në luftë.

Egzona Tërdevci, kërkojmë që me e respektu rregulloren sepse nuk ka të bëj fare me atë pikë të rendit të ditës kjo që po diskutohet këtu, derisa jemi duke fol për planin rregullues te flasim për planin jo për anën tjetër.

Arbër Halilaj, mendoj se është debat i pa nevojshëm në këtë mënyrë që po behet për arsye se secili këtu jemi me votën e qytetarit dhe secili përfaqësojmë interesat e tyre, me se paku plani rregullues i hollësishëm ka të bëj më atë se si quhet kush e ka propozu, ku është synimi, kështu që kalojmë në çështje përmbajtjesore e jo me çka lidhet zgjerimi i sheshit apo plani rregullues.

Valentina Leku, kërkoj që mos me nderru kahe të kësaj seance ne nuk mundemi me e ia imponua askujt me e votu thjesht mundemi me kërkuar që mos me penalizu një projekt kaq të mirë për me u zhvillua Drenasi, kërkoj ta votoni sepse po realizohet diçka e mirë.

Labinot Halilaj, ju po kërkon zgjerim te sheshit dhe shko kqyrne gjendjen aktuale të sheshit çfarë e kemi dhe ju po kërkon zgjerim të sheshit dhe është neveri kur dikush mundohet ti përdor heronjtë tanë, fyerja me e madhe është ai diskutim.

Filloreta Bujupi, edhe pse nuk jemi tek pika e rendit të ditës dashta me u ndërlidh gjitha bizneset po mbyllen për shkak të zgjerimit të sheshit, ju e dini që krejt bizneset që kanë berë një peticion dhe e kanë pru në komunë kundër zgjerimit të sheshit.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- nuk jemi në rend dite, kërkoj mirëkuptimin tuaj, nuk kemi qka të diskutojmë.

Meqë nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime tjera kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 31 anëtar, **(Për)** votuan 14 anëtar, 17 vota kundër, abstenim nuk pati, nuk u miratua propozim vendimi për miratimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për Qendrën e Qytetit Gillogoc.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e katërt të rendit të ditës: **4. Propozim vendim për kompensimin e anëtarëve të Komisionit për zgjedhjen e kryetarëve dhe këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane në Komunën e Drenasit.**

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- Propozim vendim për kompensimin e anëtarëve të Komisionit për zgjedhjen e kryetarëve dhe këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane.

Anëtarët e KPF-se lidhur me propozimin në fjalë rekomanduan zyrës së kryetarit që të ndryshohet Propozim vendimi neni II, ku thotë: anëtarët e komisionit do të kompensohen për punën e kryer me shumë prej 50 euro për çdo ditë pune, ndërsa KPF-ja propozoi që për secilin anëtar pagesa të jetë për gjithë punën e kryer vetëm 300 euro.

Malsore Cakiqi, jam për votimin e propozim vendimit për kompensimin e anëtarëve të komisionit për zgjedhjen e këshillave të fshatrave, për kundër disa parregullsive të mbajtjeve të këtyre mbledhjeve.

Egzona Tërdevci, edhe ne jemi për këtë propozim vendimi. E përgezoj KPF që e kanë zbrit shumën për kompenzimin e anëtarëve të komisionit, konsideroj se shuma 300 euro është në rregull të paktën i mbulon shpenzimet që i kemi.

Arben Shala- Nënkryetari i Komunës, shuma e komisionit ka qenë e njëjtë me administatoret e fshatrave, administatoret do të mbajnë 6 takime në vit, të cilat paguhën 50 euro.

Azemine Bujupi Gjoka, ne këtë propozim vendim për kompenzimin e anëtarëve të komisionit për zgjedhjen e kryetarëve dhe këshillave të fshatrave.

Labinot Halilaj, anëtarët e komisionit të cilët janë nga asambleja është mirë mos me marrë pjesë në votim për shkak se i bjen konflikt interesi, dhe unë jam për këtë propozim vendim.

Hamit Haxhiu, nuk do të marrë pjesë në votim për shkak se jam pjesë e komisionit.

Meqë nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime tjera kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 31 anëtar, **(Për)** votuan 27 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati, u miratua kjo pikë e rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e pestë të rendit të ditës: **5. Propozim vendim për rialokim të mjeteve financiare nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.**

Arbër Halilaj, duke pas aresyetimin e këtij propozim vendimi dhe meqë ka të bëjë me drejtorinë e shëndetësisë me autoambulancat e vjetruara dhe jo funksionale, jam për që në këto raste të riallokojmë mjetet financiare prandaj e përkrahi këtë propozim vendim.

Mehedin Salihu, po ashtu edhe unë e përkrahi këtë propozim vendim edhe pse në një të ardhme shumë të afërt edhe pse kemi nevoj me shumë, për fillim edhe unë e përkrahi këtë ide edhe pse nevoja është edhe më e madhe edhe me shumë së një autoambulace.

Egzona Tërdevci, parimisht edhe unë e përkrahi këtë ide, por pyeti tek arsyeshimi thuhet se ende është duke u punua rregullorja për sistematizim të vendeve të punës a planifikohet të përfundohet kjo rregullore brenda vitit 2023?

Meqë nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime tjera kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 31 anëtar, **(Për)** votuan 31 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati, u miratua kjo pikë e rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e gjashtë të rendit të ditës: **6. Propozim vendim për rritjen dhe bartjen e të hyrave Vetanake.**

Arbër Halilaj, i përkrahi gjitha projektet tjera meqë në kuadër të këtij propozim vendimi është riallokimi i mjeteve për zgjerimin e sheshit jam kundër.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci-, kërkoj që ta votoni këtë pikë të rendit të ditës lidhet edhe me grandin e përfomances prej 2 milion e 47 mijë euro për zhvillimin e projektit të sheshit të Drenasit, ju rikujtoj asnjë mundësi nuk e kemi me ndryshu në këtë drejtim sepse kemi lidh momerandum me MAPL-në me donatoret DEMOS dhe ne nuk rrezikojmë vetëm humbjen e 2 milion e 47 mijë euro por rrezikojmë edhe humbjen e 1 milion e 600 mijë euro duke përfshi edhe projektet tjera, sepse aty hyn edhe shpronësimi e banesave hyn edhe projekti për token ne komasacion që qytetaret të komunës tonë për herë të parë pas 39 viteve mujn me pas fletën poseduese për token e vet që e kanë që deri me tani nuk ka mujt me marrë, pra ky mos votim zingjir i shkakton dante ose humbje te investimeve prandaj është më rendesi për asambleistete tanë se qka po vototjne sot, a po votojnë humbjen mbi 7 milion euro për komunën tone, prandaj kërkoj nga ju që ta votoni këtë propozim vendim sepse është në të mirën e qytetareve dhe zhvillimit ekonomik, ju lus qe mos e dëmtoni për interesa e intae individuale një buxhet te cilën e kemi ne dispozicion për Komunen e Drenasit prej 3 milion e 600 mijë tani dhe një buxhet që e presim mbi 3 milion me marrë vetëm prej grandit të përfomances për vitin 2023, pra është në dorën tuaj me ec përpara apo me kthy komunën tonë mbrapa.

Drin Halilaj, a kemi mundësi me i nda këto projekte përveç zgjerimit të sheshit?

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, jam mundu gjitha metodat me i zhvillu, nuk kemi asnjë mundësi sepse është e lidhur me grandin e përfomancen nuk ndahen nuk mundemi me bë asgjë, me 2 milion e 400 mijë nuk mundemi më zhvillu as procedura as asgjë dhe nëse nuk mundemi me i hargju 75 % te grandin na e humbin garën për vitin 2022 për grand të përfomances, prandaj po ju lutem mos ia humbni Drenasit 7 milion euro.

Labinot Halilaj, nuk e kam të qartë, ne po flasim për humbjen e grandit të përfomances, nëse ne e kemi përfitua grandin e përfomances por ku është lidhshmëria e grandit të përfomances me këtë propozim vendim për rritjen dhe bartjen e të hyrave vetanake, ne të hyrat vetanake i orjentojmë ku do, dhe nga ana tjetër propozimi na ka ardh pa shpalosje, u dasht me ditë se nga kanë me u orjentu mjetet, vlera totale po por shpalosje nuk ka, unë mendoj se grandit nuk humb dhe qëndroj pran asaj që grandit nuk humb se nga i bartim ne te hyrat tona vetanake.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, gara për përfomancë komunale lidhet me përfitimin e grandit, grandit lidhet me bashkëfinancim sepse e fiton një grand ne duhet me hy bashkëfinancim thuajshe përgjysmë me grandin për me mujt me e kry një projekt prandaj nuk

ka asnjë mundësi e heq apo me e dergu diku tjetër sepse ne kemi lidh momerandum me MAPL-në bashkëfinancim.

Florentina Elezi-Veliu, a e keni një shifër të saktë sa kushton zgjerimi i sheshit?

Labinot Halilaj, lidhem me grandin e performances, nëse grandin ne po dashka me participim, sa është participimi në projekt, dhe deri kur është afati që që ky grand duhet të tërhiqet ose të realizohet projekti a ka ndonjë afat?

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, 2 milion e 47 mijë euro janë grand dhe 1,146,544.88 euro janë këtë vit të hyra vetanake dhe projektuesi e ka paraparë me kushtu 4 milion e 300 mirë euro për tri vjet, nga këto varet se sa hyn operatorët ma lirë se ma shtrejt nuk ka mundësi sepse nuk e lejon ligji, prandaj grandin duhet me u hargju këtë vit diku deri me 20 dhjetor, ndërsa mjetet tjera nëse nuk mundemi me i hargju të hyrat vetanake mundemi vitin tjetër sepse është projekt 2-3 vjeçar.

Florentina Elezi-Veliu, kam disa qytetar që më kanë shkru për me e votu këtë propozim vendim edhe pse une parimisht jam kundër, por dua të sqaroj edhe tek qytetaret se pse vota jem është kundër, grandin i performances është 2 milion e 479 mijë, 1 milion e 279 mijë janë të planifikuara që janë ndarë për buxhet për sheshin për vitin 2023-2025 plus nëse e votojmë edhe 1 milion sot po e kalon vlerën e 4,758,537.00 dmth po e kalon vlerën që ju e ceket se sa mundet me kushtu komplet sheshi po e tejkalon kogja shumë, pse nuk e keni prur vetëm me 300 mijë pra pasi që po dashka me 4 milion për shkak se ju vet e thatë që nuk mundën me pas ofertues me vlerë më të madhe, pse e keni kaq për ngut nëse të hyrat vetanake mundën me u bartë vitin tjetër, filloje një herë nisja sheshit dhe hargjoj mjetet e grandit të performances dhe nëse mbet keq atëherë e votojmë vitin tjetër dhe jo me bë presion. Vota jem është kundër.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, ne kemi lidh momerandum e kemi me ligj, e ka thënë se cilin projekt do me zhvillua me këto mjete me grand të performances bashkëfinancim. Por nuk mundemi me hap tender pa e pas alokimin e mjeteve te shumes se përgjithshme, ne duhet me pas miratim prej kuvendit për krejt mjetet që janë të parapamë në momerandum mes ministrinsë së pushtetit lokal dhe donatoreve, e keni momerandumin të publikuar në ueb faqe të komunës. Pra pa e pas krejt alokimin ne nuk mundemi me fillu me procedurat, ne nuk mundemi me hy vetëm me grandin sepse nuk e aprovon ministria sepse ka momerandum, edhe ashtu ministria nuk na lejon pa pas bashkëfinancim.

Mehedin Salihu, a janë mirë të informuar qysh behet kjo shtrirje qfar planifikimi ka sheshi, sikur ne ti kishum kry disa prioritete me herët ujin e pijes, kanalizimin e ujrave te zeza e disa kategori të ndryshme kjo kish kalu pa snje problem, une mendoj që njerzit sidomos bizneset nuk janë te informuar mirë sepse kjo punë kërkon një kohë më të gjatë.

Bekim Lestrani, meqenëse na kete propozim vendim kemi shume pa qartësi kërkoj që seanca me u shty që me marrë më shumë informacione.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, propozimi për me e shty për mendimin tim është i qëlluar sepse merrni gjithë ekspertat ku do që i keni ju pres dhe ju dha sqarime, dhe nuk kemi ndonjë rrugë tjetër perveq me e votu.

Valentina Leku, a ka mundësi me e organizua një takim por jo në seancë me u informu më mirë secili dhe kur te vijm ne seance te vendosim qka po votojmë.

Egzona Tërdevci, sot po na kërkon përkrahjen por pse nuk po na konsulton para se me na dërguar projekte të tilla, ne jemi pjesë e Drenasit dhe pjesë e kuvendit edhe ne kishim pas qasje tjetër nëse parimisht na kërkohet edhe mendimi si opozitë si kuvendar kur dërgoni projekte të tilla të rëndësishme.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, grandit ka ardh si rezultat i punës dhe vlerësimit që na ka bërë MAPL-ja dhe donatorët nuk ka qenë ma herët ne e kemi ruajt kodin e sheshit dhe duke pas kodin e sheshit ne kemi mujt me lidh memorandum me MAPL-në dhe duke lidh momerandum u dashtë me pas pjesën tonë të buxhetit. Ose kerkojmë ta shtym këtë seance apo e kundërta i humbin milion komunës tonë.

Arbër Halilaj, duke e parë gjithë këtë mos informim u dashtë me qenë prezent edhe dikush prej kompanisë projektuese që janë në aspektin profesional ma kompetent rreth kësaj fushe, projektuesi me na informuar ma detalisht pse opcioni që përmban zgjerimin e sheshit është ai i duhuri prej tri opcioneve që i ka projektua dhe tjetra nuk shoh anketim i popullatës të qendrës se Drenasit për të hulumtuar qeshtjet që ndërlidhen me planin rregullues të hollësishëm dhe pastaj përpunimi i rezultatit të këtij anketimi kishe me i nxjerr prioritetet e zhvillimit të qendrës se Drenasit bazuar në mendimet dhe propozimet e qytetareve. Neve na duhet informacion profesional të cilin kishtë mujt me dhënë përfaqesuesi i kompanisë projektuese, kërkoj me e shty seancën derisa ta sigurojmë edhe pranin e tyre dhe të vazhdojmë më tutje.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, nuk je ne tem sepse projektuesi e ka bërë projektin me u përzgjedh projekti ma i miri, sikur ai që e ka pas projektin ma të keq sikur ai që e ka pas porjektin ma të mirë e ka pas çmimin e njejtë të përfitimit të projektit, projekti e ka pas një shumë të cilën ne bashkë me ministrinë e pushtetit lokal dhe me donatorët e kemi qit në momerandum, pra është një projekt që del nga fitimi i grandit, nuk është i paraparë me herët por është si rezultat i arritjes që Komuna e Drenasit me punën e mirë i ka fitua 2 milion 47 mijë euro dhe ia shton 1 milion e gjysme, kjo nuk do të thotë që krejt paret e komunës hargjohen se krejt varet me sa euro hyn operatorët ekonomik.

Me kërkesën e asamblesë komunale seanca shkoj për 1 orë pauzë.

Pas pauzës seanca vazhdoj po me të njëjtat pika të rendit të ditës rreth orës 14:00

Egzona Tërdevci-vazhdimisht u rikujtohet ne jemi grupi tret(3) ne baze te numrit te votave qe i kemi ne asamble shkojmë e qëndrime te grupeve qe janë para neve edhe mandej deklarohemi edhe ne.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci- ky memorandum i cili ka kalu te gjitha procedurat dhe nuk ka mundësi askush me e ndrru përveç qe me i humb të gjitha këto mjete, kjo deklarata e zotimit qe përmban shumen e përgjithshme 4,342,660.60 euro duhet mu votu ne kuvend ne prej ketij memorandum i kemi marr mjetet e grandit te performances edhe nga Elvetas edhe nga ministria i kemi zotu na i kanë dergu dhe i kemi zotu mjetet që janë votu në shtator të vitit te kaluar dhe janë miratuar buxhetin e Republike se Kosovës, projeksione për vitin 2025 qe janë 374 mije e 446 mije prej tyre janë shpenzuar. MAPL i ka zotu te na 916,380.08 euro, Demosi i ka 1,118,387,08 euro, neve na duhet nga te hyrat vëtanke sot me i votu 1 milion e mije euro ne qato 1 milion e 8 mijë euro rreth 500 mije janë pagesa te cilat duhet ti behën shpronësimeve te shtëpitë në shesh, nuk ka me me i shpronësua shtëpizat pa i

shti ne projekt ,jeni asamblistë vota ju eshte e lirë, por ju kisha lut me menu për qytetaret, jeni te lire me votu qysh te doni, këto mjete janë mjete të cilat nuk dedikohen tjetër kund dhe nuk mund të shkojnë tjetër kund as kuvendi me ja nderru dedikimin sepse janë procesu kanë hy në sistem, sa i përket sheshit ministria e ka përzgjedh jo ne në i kemi ofruar 3 projekte ata e kane përzgjedh sheshin.

Albulena Saliku –Të nderur kolege nuk ka diskutim qe e është drejte e secilit prej nesh për bindjen se si te votojmë por unë e mendoj dhe konsideroj qe nuk është e drejte për këtë mënyrë bllokimeve te projekteve te mëdha e te cilat janë ne interes te gjithë qytetarëve të Drenasit ,unë kërkoj nga të gjithë koleget ta përkrahin piken 6 mos ta ndalim zhvillimin ekonomik te Drenasit unë mendoj qe po i zhgënjemë qytetarët e Drenasit, kjo qe po ndodh për mua është bllokim pavarësisht bindjeve politike çdo që është për zhvillimin e këtij vendi është mirë që të jemi unik te gjithë, të gjithë këto projekte po varen nga ne prandaj çdo vonës qe behet është ne dem te qytetarëve te Drenasit, te gjithë se bashku mund te bëjmë gjera te mëdha gjithmonë ne interes te qytetareve tanë, në qoftë qe e shihni te nevojshme qe duhet te ketë sqarime shtese mund edhe te shtyhet për seancën e ardhshme Faleminderit.

Labinot Halilaj –Faleminderit kryesues ne bëmë debate edhe ma herët kjo pike e rendit të ditës ka qene edhe ne seance të kalume pauza nuk ka sqaru asgjë hiq ,deri sa ka që kaq shume divergjencë ka shume pasiguri ,ka që kaq shume te thëna dhe te pathëna qe janë te paqëndrueshme unë mendoj qe edhe ekzekutivi nuk ka nevojë me pas ketë ngulm, ne duhet me pas te qartë edhe votimin kundër jo me dëme me i humb miliona unë mendoj qe nuk ka sqarime të mjaftueshme mu procesu kjo seance duhet me u shty, por edhe ekzekutivi mos te banë me gisht vetëm prej asamblistëve edhe ju e keni një përgjegjësi bile përgjegjësia është ma e madhe e juaja se e jona ju e keni ekzekutivin, nuk jemi ne ekzekutivi na jem legjislativ na e përkrahëm legjislacionin nëse hupin pse doza e fajit koka vetëm te asamblisti, kur është mire jam unë,kur është keq jeni ju, nëse ka amulli ne qeshjen e shtfrytezimit te grantit te performances duhet me u hjek amulli e mandej jemi ne rregull me votimet, për mendimit tim kjo seancë është dashtë mos me vazhdu.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci- granti është përzgjedh prej Demosit dhe MAPL-së për sheshin, i kemi shti 900 euro kolektor te urave te zeza nuk po shihet asgjë ne paret i kemi ku duhet edhe qysh duhet dhe kanë thanë kemi mi mburr për një projekt të cilin e kanë pëlqy shumë, ne qoftë qe nuk ju kame dhëne informacione te mjaftueshme mundeni mem pyet, ne qofte qe votohet ndryshe komuna i humb 7 milion euro dhe rrezikon krejt donatoret me i humb ne paret i kemi ne fund vitit ne qofte se nuk i kemi shpenzu ketë buxhet ne e marrim një auditim keq klasifikim e cila komuna dënohet edhe për garantët tjera qeveritare ,prej te hyrave vet anakë qe i ka komuna jone janë 1 milion e 8 mije e qe po dëshirojmë me i shti tjerat janë rreth 500 mije euro me i pagu për shtëpitë e vjetra qe i kemi shpronësuar ,ne këtë rast është përgjegjësia te ju me votu për opo kundër ju e vendosni ,votimi kundër na humb ketë grand qeto mjete dhe na humb grandin qe presim me marr .

Bekim Lestrani –Përshëndetje për te gjithë , ka kolege qe aludojnë edhe te bllokimi i investimeve ,ne takimi paraprak patëm vetëm l1 një kërkesë te shtyjmë seancën për një kohe ti hjekim këto pasiguri nuk jemi për me i blloku mjetet, thjesht me u bind secili prej neve prezantimi këtu ,unë po propozoj qe te shtyjmë seancën, Faleminderit .

Muhedin Salihu –Faleminderit kryesues, Kërkesa jone për sqarime shtese është e arsyeshme jemi për te gjithë për me ardh me be mire këtë vend me e zhvillu unë jam për me u shty për me u sqarua gjanat për mos me u blloku kjo situatë kështu.

Kryetari i Komunës Ramzi Lladrovci- Jemi duke folur publikisht ne qofte se nuk votohet ky buxhet si rezultat i këtij memorandumit qe e kemi bere me ministrin ne rast qe nuk i humbim 7 milion euro ne e kemi humbur garën për 3 milion tash qe presim mi marr ,ne rast qe nuk nuk i humbim 7 milion euro unë kame dhanë dorëheqje ,dëshiroj qe komuna jone mos me i humb 7 milion euro spravonum a i humb a si humbim 7 milion euro, Faleminderit.

Egzona Tërdevci- e përmende më herët se ju nuk jeni aj që e keni përzgjedhë projektin, projekti është përxgjedhë nga financusit cilat janë kan dy projektet tjera të jemi korrekt me krejt ata që janë duken na ndjek ta dim edhe ne tjerët, memorandum është nënshkruar në Mars edhe ju jeni përgjegjës që keni hup koh deri tash edhe ju mani përgjegjisin e juq që nuk e keni sjell deri tash konkretisht muajin e kaluar edhe mbani përgjegjisi që nuk na keni konsultu si asambleist prej fillimi nëse e kishim diskutu bashk edhe nëse ishim dakordu bashk si asamble me dërgu një project që krejt e kishim konsideru që është në interes të mirës së përgjithshme sot nuk e kishe pas problem me i siguru voten e asnjërit prej nesh.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci – dy projektet tjera janë kolektort deri te guri I plakës kan thënë nuk po shihet asgjë bane ket gjë ne tri propozime I kemi dërgu dhe rehabilitimi I rrugëve që u kan, zgjerimi I rrugëve me tre korsi edhe katër korsi në gjithë Drenasin janë kan këto tri projekte. E dyta është që ne I humbim mjetet nëse nuk fillojm më shpejt me zhvillu projektin. E keni në memorandum mundësh me gjet te grandet e performancës jan dikun 30 ose 40 faqe aty e shihni në qoftë se nuk e zbaton projektin nuk I hargjon 70% të mjeteve të grantit që janë shumë nene të cilat e dëmtojn ose e humbin edhe garen për grant në qoftë se tash hym edhe si hargjojm 70% ne gjithëqysh e humbin grantin po nuk mundemi me marr ma grant edhe ato 30% I humbim prapseprap çahet komuna me I qit qoft me alokim qoft me rishiqim, qoft me përmbarues nuk jam duke ju mashtru se jan në pyetje 7 milion për komunën e Drenasit

Valentina Leku Gashi- duke u bazu në debate këtu deshta me ba një pyetje nëse votojm pro këti projekti na po bim diqka po zhvillojm po arrijm diqka, qka arrijmë nëse e votojm kundër masi kaq shumë dilemma veq po humbim diqka të madhe.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci – Unë po mundohem me I tregu që po I humbin 7milion euro për Komunën e Drenasit asgjë tjetër.

Azemine Bujupi– faleminderit Vertet pom vjen keq në qfar pike keni ardh, deri aty që nuk mujna me u kuptu ose me pas një lloj bashkpunimi lidhur me projektet të cilat I keni konsideru si prioritet edhe për deri tash e keni gati mandatin e tretë edhe nuk keni mujt me ardh në përfundim se një project që qenka prioritet edhe patjetër pu dashka aj me u realize ose nuk realizohet mjetet poi humbkan, pse për projekte tjera nuk jan humb mjetet po gjithëmon I kemi transferi prej në rektori në sektorin tjetër. E dyta nuk jemi kundër ndërtimit të sheshit por nuk ka qen prioritet edhe nëse I keni dëgju kërkesat e qytetarëve e komentet që janë dhanë asnjë nuk kanë pëlqy që mu zgjeru projekti edhe me shku 7 milion euro për projektin, pse nuk keni investu në një fabric ku kishit mujt me I punëse të rinjët p.sh një gjenerat 2022-2023, 400 maturant e kryen shkollën ku doni me I dërgu ata. A doni me I pru në shesh aty me u ul a qka pse nuk po krijoni kushte të mira për qytetarët e Drenasit që edhe ata me I ndi pak krenar edhe ne me ju votu juve e jo me ardh në kët pik sa që me rujt sheshin pa pas nevoj, donator nuk mundet me vendos pse nuk po vendos projekte tjera po pi vendosi veq ato që janë në interes për juve.

Labinot Halilaj – Singerisht po them qka ka të keqe me u shty seanca ani tjerët mesi po insistojnë qka ka të mirë me u votu në mënyr të mjegullune atëher të hym në process të votimit në mënyr të mjegullune, hymn në process të votimit përgjegjësin le ta marrin gjithkush për atë që po insiston nëse shtyhet seanca për të hënën ose të martën ka qka diskutohet ende rreth kësaj pike të rendit të ditës ka ende paqartësi rreth kësaj pike të rendit të ditës skem nevioj na me kokfortësi këtu me i zgjidh qështjet, vime në seanc të hënën të martën ose të mërkurën votojmë për, kundër, abstenim edhe prap është në dorën e asambleistave.

Egzona Tërdevci – unë jam deke e lexu memorandumit neni 8 afati I realizimit të projektit, paragrafi 2, neni 8 thot se komuna duhet të ndërmarr masa që projekti I financuar nga demos të filloj në vitin 2023 dhe të përfundoj brenda vitit fiskal 2023 në rast se projekti nuk përfundon gjatë vitit 2023 Komuna mund ti bart mjetet e pa shpenzuara të GPK-së në vitin 2024 për vazhdimin e projektit sipas kësaj marrëveshje fondet e pa shpenzuara sipas neni 3.3 duhet ti kthehen Demosit jo më vonë se 25.12.2024 domethan nuk jemi duke fol për vitin 2023 po jemi duke fol për vitin 2024 edhe neni 10 ndryshimet dhe ndërprerja e marrëveshjes së bashkfinancimit, marrëveshja mund të ndryshohet dhe plotësohet sipas pëlqimit paraprak të MAPL-së Demosit dhe Komunës nuk pot thot që nuk ka mundësi me u ndryshu

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci – Nuk mundësh me dërgu tjetër project pra të njejtin project mundemi me I dërgu mjetet se ne grantin e 900 mijë euro duhet këtë vitë me përfundu, të hollat tjera edhe në 2024 mundemi me i përdor deri në 25.12.2024, lexojeni më mir edhe qitne në votim unë vetëm qytetarëve po ju them që 7 milion euro nëse votohet ndryshe i humb Komuna e Drenasit dhe i humb të gjitha garat për me fitu grantin e performancës, nëse jeni të paqartë mos me ba gabim nëse jeni dakord unë nuk humbi për me shty seancën me votu kundër humb Komuna, humb qytetari i Drenasit edhe humbim të gjithë bashkë

Azemine Bujupi – Deshta me i tregu kryetarit që unë sponzorizues nuk kam, unë plot projekte tjera që janë në interes të qytetarëve dhe bashkfshatarëve të mi kom kërkuj këtu dhe asnjëher nuk është realize asnjë segment i caktun e mos u lidh me ato bedela se unë nuk kam lidhje me kërkan unë po du me than diqka që qka është e rëndësishme për qytetarët mjetet të cilat ke mujt edhe ma heret mi shfrytëzu ose mi dërgu dikun ku është në interes për qytetarët kaq po kërkoj.

Azemine Bujupi – sistemin e ujit të pijës më së pari jo njëher po 20 her, kanalizimin keni pas me përfundu nuk është përfundu ndriqimin keni pas me ban në qdo fshat ku ka pas shtylla e keni ba veq aty ku ju kan lidh me interes për njerëz të caktun e nuk e keni dërgu ty ku është nevoja, për projekte tjera most të flasim që janë madhore e në interes për qytetarët por unë po I kërkoj kërkesat më elementare

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci – për të gjithë asambleistat sistemin e ujit e kom përfundu edhe sponzorizuesit tu e kan marr në qaf sistemin e kan lanë pa gypa kan ba pagesa pa i vendos gypat në tokë unë i kom ba pompat ja kom dorëz qe 6 muaj ajë duhet me lëshu gypat me punu kanalizimin 90% e kemi kry nepër qdo fshat nëpër qdo lagje jem tuj dërgu kolektorin në drejtim të gurit të plakës. Ndriqimin qe dy vjet e kishim kry OSHB nuk ka funksionu tash jemi duke e përfundu i kemi ba mbi 100 km ndriqim të ri 90% po thujse e kemi përfundu në qdo lagje prandaj thash ami tri projekte që nuk i kemi as në process edhe që nuk I kemi marr parasysh nuk mundesh me than se të gjitha i kemi bë.

Mbledhja u ndërpre rreth orës 14:55 për të vazhduar një ditë tjetër me koordinimin e asamblesë komunale.

Vazhdimi i Mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal të Drenasit, të mbajtur më 26.05.2023, u mbajt më dt. 31.05.2023 (ditë e mërkurë) duke filluar nga ora 10:00 në sallën e Kuvendit të Komunës. Mbledhja do të vazhdojë me po të njëjtin rend dite e cila u miratua nga asambleja komunale në mënyrë unanime në mbledhjen e mbajtur me dt. 26.05.2023.

Prezent gjatë vazhdimit të mbledhjes ishin: Nënkryetari i Komunës z. Arben Shala, drejtor të drejtorive komunale, 29 asambleist të Kuvendit Komunal, mungoi Sali Dvorani dhe Mirlinda Dvorani.

Milaim Hajdari-Përshëndetje për të gjithë i nderuar nënkryetar z.Shala, të nderuar Drejtor, të nderuar asambleistë, të nderuar të pranishëm, po vazhdojmë mbledhjen e rregullt të Komunës të datës 26.05.2023, jemi në pikën e gjashtë të rendit të ditës, 6. Propozim vendim për rritjen dhe të hyrave vetanake, po shkojmë përmes grupeve parlamentare po shkojmë me rend.

Milaim.Hajdari-Pika e 6 e rendit të ditës ,Propozim vendim për rritjen edhe bartjen e të hyrave vetanake ,ashtu siç kemi rënë dakord me u sqaruar në lidhje me këtë pikë të rendit të ditës ,a ka ndonjë propozim tjetër që na ndihmon në sqarimin e kësaj pike kisha pas dëshirë prej jush me marrë një vendim a jeni për me shty si pikë komplet deri sa të plotësohem me sqarime e nevojshme ju jeni ata që vendosni.

Bekimi Lestrani- Grupi Kuvendar i PDK-së përshëndetje për të gjithë, ne si grup parlamentar kemi vendosur që me votën "PËR" këtë pikë të rendit të ditës për arsye që ne bazë të gjitha diskutimeve duke i parë të gjitha opsionet mundësi për me i humbur mjetet e qytetarëve ekziston edhe në fakt ne i kemi vërejtjet tona, kemi mujt me shku me prioritet tjerë, por edhe reagimi jonë nuk ka qenë më kohë qysh në fazën e projektimit, tash kemi ardhur në një situatë që me vu në pikëpyetje a me i humbur këto mjete apo me vazhdu me këtë projekt. Dhe në rastet tjerë me vazhdu me projektet sipas prioritetëve.

Azemine Gjoka - Grupi Kuvendar i DD-së - Përshëndetje për të gjithë, argumentet tona si ne DD që nuk votojmë "PËR" është mungesë totale e informacionit për zhvillimin e këtij projekti, kemi zhvilluar të gjitha procedurat në konfidencë të plotë dhe nuk jemi konsultuar me ne, ne vlerësojmë që qytetari ka nevojë me të domosdoshme që të realizohen projekte që e lehtësojnë jetën e qytetarit, në rast që zhvillohet projekt që do të lehtësojë kualitetin e jetës së qytetarit tanë siç është: uji i pijes, trajtimi i ujërave të zeza, zgjerimi i rrugëve, rregullimi i shtetit të lumit të evitohen përmblytjet do të kemi mbështetjen tonë unanime.

Egzona Tërdevci- Grupi Kuvendar i VV-së përshëndetje për të gjithë, letrën që kemi pranuar dhe ne grupin e komunikimit në viber do të ishte në rregull po ta pranionim në shkurt ose mars para se Komuna të aplikonte me projekte për financim, por ta pranojmë një ditë para votimit është e kotë nuk ka ndiku asgjë, vetëm na ka irrituar secilin prej neve, në postimin publik që e ka bërë Komuna e Drenasit në faqen zyrtare në facebook me dt. 14 Mars thuhet që 4.5 milion euro nga granti performancës për ndërtim dhe zgjerim të sheshit kjo është e pavërtetë, nëse e shikoni memorandumën kjo shumë nuk është vetëm nga Grandi i Performancës, MAPL-ja do të bëjë një financim prej 916.388.80 euro, Demosi 1,118.387.08 euro, dhe Komuna e Drenasit do të financojë vlerën prej 2,457,884.72 euro, këtu i kemi dy paragrafe të fundit në këtë postim shumë kunderthenesë njera me tjetrën, paragrafi i parafundit thotë: këto mjete për realizimin e këtij projekti nuk do të shpenzohen nga buxheti i përgjithshëm i Komunal por janë mjete të përfuturara nga Grandi i Performancës komunale ku Komuna e Drenasit në nivel vendi ka fituar

vendin e parë, pastaj paragrafi tjetër e demanton këtë paragraf ku thuhet se një pjesë e mjeteve të dedikuara për këtë projekt do të jene nga grandit i përgjithshëm i performances ndërsa një pjesë tjetër do të shkon nga të hyrat vetanake. Tek neni i tretë i momerandumit thuhet që ky projekt do të bashkefinancohet nga MAPL-ja, DEMOS dhe Komuna për arsye se komuna ka aplikuar vetëm me një projekt, pra komuna e Drenasit nuk ka aplikuar për tri projekte.

Arbër Halilaj- Grupi Kuvendar i GREEN-së, përmendi edhe disa fakte të rëndësishme kolegia Egzona meqë mungoni e lëshoj incizimin në salla të kuvendit komunal të seancës të datës d.m.th. kryetari ka dergu tri: Propozim vendime mirëpo në nenin 3 siç u cek se Komuna ka aplikuar vetëm me një Projekt pavarësisht kësaj duke qene asamblistë dhe duke qene zëri i qytetarëve këtu në asamble, unë nuk jam kundër projekteve zhvillimore të komunës së Drenasit përkundrazi të gjithë duhet të angazhohemi në synimin që Drenasi të zhvillohet dhe të shihet që në vendimet tona po ndikojmë në përmasimin e jetës së qytetarëve mirëpo nga kontaktet e përditshme me qytetare prioriteti i fundit i qytetarit edhe zgjerimi i sheshit, d.m.th. i kemi përfunduar të gjitha prioritetet tjerë që ndikojnë në jetën e qytetarit siç janë; ujë zgjerimi i rrugëve, unë si asamblistë nga Green në fakt ishte dashtë me qene Pro hapësirave të gjelbëruara dhe hapësirave rekreative për qytetare mirëpo kur e shoh që të gjitha prioritetet tjera që janë madhore dhe që e prekin pritshmërinë e qytetarit janë realizuar ose janë në përfundim e sipër, këtu thirrja në transparencë në llogaridhënie komunikim me qytetarin ndërsa shihet që jo vetëm qytetaret e Drenasit, ju të gjithë dhe unë si asamblistë jemi anashkaluar nuk është marrë kurrfarë opinionit nga ne se cili mendon që është prioriteti të cilat shtynë përpara në ministri në Demos para se të bëhet nënshkrimi i momerandumit, në një rast ku je i anashkaluar dhe të vihet para pozitës voto pro ose kundër diçka tjetër nuk pres prej jush sepse po humbin 7 milion, është pozitive e aktit të kryer, u cek edhe nga asambleistja Tërdevci që nuk është e vërtetë që ndërliken ato projeksione buxhetore të kryetarit në atë mënyrë sepse i bie që nëse granti i performances 2022 e a thekson grantin e performances 2023 atëherë ai ka me atëkështu 2024-2025 deh kështu në vazhdimësi, unë se pari si asamblistë ndjehem i anashkaluar, nuk kanë qene pjesë e këtij debati të rëndësishëm që është prioritet në qendrën e Drenasit kjo ka mund të bëhet shumë në një mënyrë edhe të jete konstante ky bashkëbisedim me qytetaret, në mes të projeksione buxhetore edhe asaj top prioritetin për qendrën e qytetit unë jam që të mbroj interesin e qytetarit që zëri i qytetarit dhe interesi i tij është primar para ministrit, Demos, kryetarit sepse qytetari na ka prurë këtu që të mbrojmë interesat e tij primare, kështu që natyrisht vota ime do të shkojë kundër, jo kundër projektit të sheshit edhe pse ju them publikisht që është projekt që nuk ndalet por mënyra se si është procesuar prej fillimit edhe kjo frymë e mos bashkëpunimit dhe unitetit nuk është e vërtetë ajo që shënohet në viber që kemi unitet kurrë nuk kemi pasur unitet prej fillimit të konstatimit të asamblesë gjithmonë kemi votu me inate personale dhe jemi dhënë në disa raste në pozita voto për sepse ti je kundër zhvillimit të Drenasit, kryetari ende ka mbetur në fushat zgjedhore e nuk po përfund fushata e tij zgjedhore kështu që për mos u shtyrë për inate personale unë flas për interesa të qytetarit që me thotë të mos kalojë ky votim dhe votoj kundër, edhe e kisha lut kryesuesin të caktoj një admin të faqes në viber dhe kryetari si ekzekutiv nuk ka nevojë të jete pjesë e grupit tone në viber dhe të na bëjë presion kinse me sugjerime dhe këshilla por në jemi mjaftueshëm të pjekur nuk kemi nevojë për sugjerime se si duhet të votuar në një rast të caktuar kështu që në i diskutojmë brenda grupit por jo të marrim sugjerime prej ekzekutivit, Faleminderit.

Arben Shala Nënkryetar i Komunës –I nderuar kryesues, të nderuar drejtor, të nderuar asamblistë, u thane shumë gjera këtu duhet të sqaroj disa sheshi nuk kushton 7 milion, sheshi kushton 4 milion e diçka, të gjitha ato projekte që i përmendet janë në proces e sipër duke punuar në to, kryetari nuk ndodhet sot sepse ndodhet në komisionin ndër ministror besoj që

kish me qene mire qe partia qe e përfaqëson ti përkrah ato projekte te cilat tashme ka dy vite qe zvarriten edhe qe janë ne interesin e gjithë qytetarëve te Drenasit qytetaret e Drenasit përfitojnë ,ne qofte qe i dëgjoni rregullat për grand te performances duhet te jepen sqarime edhe nuk kemi kohe për ligjërata ,granti i performances thotë qe përdorët për investime kapitale dihet cili është viti fiskal dihet qka ndodh me ato qe nuk shpenzohen gjate vitit fiskal ,thotë qe projektet duhet te jene projekte te kufizuara ne numër për te shmangur proceduarat e gjata administrative dhe për te shfrytëzuar mjetet brenda vitit fiskal, thotë duhet te shfrytëzohet nga komuna komform legjislacionit ne fuqi edhe qeshtje te tjera ,pe shohë qe ka shume paqartësi dallimit midis ekzekutivit dhe legjislativit mire është mi dite ato dallime. Faleminderit!

Egzona Terdevci – Grupi Kuvendar i VV-së Faleminderit kryesues nënkryetar, realisht nuk the kurgjo qe e përgënjeshtrojnë ato qe e tham na ,qytetaret po e din tash edhe plotësisht e vërtet asnjë argument i joti nuk është si kundërshtim i asaj qka thamë na ,edhe unë thash qe duhet mu shpenzu mjete brenda vitit fiskal, MAPL i intereson brenda vitit fiskal 2023 mu shpenzu mjetet qe i ndan ajo ,edhe demosit i interesojnë mjetet e tyre askund nuk ka përcaktim se si komuna ka mi shpenzu mjetet qe duhet mi shtu për atë projekt ,dye jemi ne te njëjtën linje s jem etu thane kurgjo ndryshe, ju e dini qe vetëm mjetet e demosit edhe mjetet e MAPL duhet mu shpenzu ,mjetet e komunës nuk mundet askush me ta percaktu si i shpenzon.

Pas diskutimeve, vërejtjeve dhe sugjerimeve kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 29 anëtar, **(Për)** votuan 18 anëtar, 11 vota kundër, abstenim nuk pati, u miratua kjo pikë e rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e shtatë të rendit të ditës: **7. Propozim vendim për rialokim të mjeteve financiare nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.**

Shyqyri Bublaku- përshëndetje për te gjithë, një sqarim kanë kërkuar MAPL qe projektet jo qysh i kemi bere rialokimin propozimet e viteve te kaluara përcaktohet vetëm kodi i projektit edhe burimi i financimit ky ndryshim edhe vetëm për këto ky është ndryshimi,

Pas diskutimeve, vërejtjeve dhe sugjerimeve kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 29 anëtar, **(Për)** votuan 25 anëtar, 4 vota kundër, abstenim nuk pati, u miratua kjo pikë e rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e tetë të rendit të ditës: **8. Propozim vendim për miratimin e kërkesës. Nr. 01-070/01-0023340/23, 17.5.2025, për ndihmë financiare për mjekim urgjent të sëmundjes – kancer ovarian, në shumën totale prej 3,000.00 euro.**

Egzona Tërdevci- meq nuk e di sakt qyshë bëhet ndarja mbi qfar baza për këto a ka pas mundësi Komuna me me nda më shum mjete e di që shuma që kërkohet për zonjen Dobra është shum e madhe dh është shumë e vështir me u realize prej familjes.

Shyqiri Bublaku-Drejtor i Financave, duke u bazuar në atë se bugjeti I vitit 2023 është aprovuar në shtator të vitit të kaluar dhe mundësit me nda shuma më të mdha dmth krejt shuma e subvencioneve eshte e përcaktuar për kqa kan me u nda mundësit të limitume nuk ka pas mundësi edhe nuk është rasti I vetem fatkeqsisht kemi shumë raste që bëjnë kërkesa dh e

nuk kemi mundësi me iu përgjegj për shkak të kufizimeve buxhetore dhe neve në këtë vit në vitin 2024 na kërkohet që subvencione të rriten vetëm 3.7% nga viti I kalum domethënë i kemi 420.000 në vitin 2023 kam me u bo 434.000 € buxheti për subvencione domethan mundësit buxhetore janë të kufizune dhe të limitume nuk kem mundësi me nda shuma më të mdha.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, present gjatë votimit ishin 29 aëntar: 28 votunan “Për”, kundër nuk pati, 1 abstenim, u miratua kjo pikë e rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e nëntë të rendit të ditës: **9. Subvencionimi i fëmijëve që vijnë kopshtet private në Komunën e Drenasit, për familjet me të ardhura nën 400 € në muaj.**

Egzona Tërdevci- ne kemi kërku në emer të grupit që drejtorja që i përgadit propozimet për buxhet me na i sjell propozimet se qysh duhet me ba, kryetar at dit ka thënë që është e mundur u asjell propozimin, a na keni sjell një propozim të till.

Milaim Hajdari-jo nuk ka propozim vendim të till nuk kemi pranë si sekretari po megjithse ka qen disponimi I pjeses dermuese të antarve të kuvendit ose I të gjithve me përkrah atëher e lam si mundësi që tutje të bëhet një propozim vendim që të shihet baza ligjore

Florentin Elezi- më falni më mirë është me specifiku se qysh kemi mendu se na duhet edhe mendimi I juaj edhe I kolegëve asambleist sipas neve kemi mendu që për nënat vetushqyse me qen 50% subvencionimi, ndërsa për fëmijët e tjerë për familjet që kanë të ardhura mujore nën 500 euro ose 400 euro ne po e propozojm kështu pastaj I specifikojna bashkarisht sepse kjo ide le të jet e përbashkët gjithashtu e dim që nuk mundemi me I realize per vitin 2023 por për vitin 2024 por sot le të kalon pastaj në vitin 2024 me fillu realizimi I kësaj

Bekim Lestrani- ne pa pasur një propozim konkret nuk mundemi me procedu, duhet me hap opcionin për me ardh me një propozim konkret se duhet me caktu formen, ka shumë elemente që duhet me kan pjes e një propozimi duhet me kan edhe në cilat kode mundemi me I marr mjetet apo ndonjë projekt që e rrezikojn duke I tërhjekur këto mjete po megjithatë ne jemi për me ba një propozim por ky propozim me kan konkret ne edhe në pjesën e par të seances idea u kan që me hap si ide me shqyrtu se nuk është që mundemi në këtë fazë.

Florentina Elezi Velu -Unë atë dit edhe e kom sqaru pak a shumë qe kom dashtë me parashtru për rend të ditës edhe e kan votu unanimisht nuk e di sot qka paska ndryshu ose them më mirë paskan ndryshu shumë gjëra por ne mundemi me votu me jep iden qysh e jepa unë po them që pavarisist të ardhurave nënat vet ushqyse me u subvencionu me 50% ndërsa për familjet që kanë të ardhura nën 500 le të votojm sot parimisht kështu në qoftë se është diqka që nuk shkon atëher MAPL qysh I ka kthi vendimet tjera mundet me kthi edhe këtë.

Bekim Lestrani- e nderuara këtë që po e thu ti ne e kena votu nuk po di qysh me ta sqaru, ne e kemi votu që kjo me ardh ose me u inicu tash qka dojmë me votu prap.

Labinot Halilaj-asnjd debat nuk ishte qe mos me u përkrah poropozimi I Florentines nese ne shkojm në aspektin që mi dha kuptim që kur të bie të plotsohet materiali edhe ne jem për qitash me votu qysh do që vlersohet me votu por me aktin kur po thojm ne me pru materialin që me pas kuptim materiali për diskutim atëher kaq është muhabeti mos rrini me asi ide ka

ndryshu nuk ka ndryshu kur na shkojna idea është që nashta mujna me ba një votim në parim me përgadit materialin për seancën e ardhshme edhe vjen si pikë e rendit të ditës propozimi I njejt edhe kompletohet materiali edhe votojm edhe I dhajm kuptim edhe kësaj që po diskutojm sot në parim e votojm nuk shkon për MAPL deri sat të bihet materiali I kompletun në seancën e radhës me u fut si pikë e rendit të ditës edhe ne jemi në rregull.

Shyqyri Bublaku-sa I përket propozim vendimit të gjithë ken edhe në mbledhjen e kalume edhe tash jemi të gjithë edhe ekzekutivi edhe legjislativi mirpo për me ardh te një propozim vendim ne duhet me dit numrin e atyne fëmijëve sa mund të ndjekim, koston e asaj shume, prindrit qfar të aedhura kan duhet me u nxjerr me u specifiku të gjitha shenimet tandi me shku me propozim vendim edhe me dit shumën se nevojat ndoshta jan shumë më të mëdhaja po ne mundësit buxhetore I kem më të kufizune ndoshta nuk kem mundësi me I mbulu pot kem me I mbulu një klas që është më të ardhura më të ulta ne mundem me I percaktu tash edhe pesqind edhe gjashqind mirpo deri sa nuk e kem numrin e tyre deri sa nuk I dim te ardhurat e ptindeve të tyre nuk munemi me marr një propozim vendim duhet ti specifikojm ti hartoj ketu i qesim në kuvend edhe normalisht që ka me u kry.

Florentina Elezi Veliu- Në rregull pajtohem që sot parimisht po e kalojm pastaj në mbledhjen e radhës me ardh si propozim vendim pershkak se nuk është faji dhe I joni pak ndoshta edhe I drejtoris ose nuk jemi sqaru mirë adit se ne veq e lam që me përgadit drejtoria kështu që ne kemi mendu që veq është I përgadit propozim vendimi që te jet sqaxim për asambleist, po pajtohem që në mbledhjen e radhës me ardh me propozim vendim

Muhamet Gjoka-I përshendeti të pranishmit, meqense po mbetet për me u definie me u qartësu edhe kostoja, numri, vlera edhe disa specifika unë dua të ndaj me ju disa informata sa I perket edukimit parafillor ne si drejtori e arsimit jemi në kordinim të vazhdueshëm dhe në bashkpunim me Ministrin e Arsimit kemi dërgu dusa propozime për nërtimin ose adoptimin e qerdheve të anekseve të shkollave në qerdhe domethan veq I kemi dërgu në ministrin e arsimit tri propozime të detajune me projekte konkrete, propozimet kan shku në Arllat Llapushnik dhe në Terstenik fillimisht si lokalitete më të mdhaja ku presim me përfshi një numer më të madh të fëmijëve pra këtë më pas ju si informat që kjo domethan hapja ose adoptimi I këtyre anekseve për qerdhe të rea nënkupton edhe rritjen e numrit të fëmijëve që do të vijojn në këto qerdhe sigurisht që në parim jemi për duhet me u pa kostoja buxhetore që me u planifiku për vitin 2023 në kuadër të kategorive të subvencioneve kjo don një analiz dhe në baz të asaj analize besoj që vjen unë këtë e ndava si informat që njohës të arsimit e kan vertetu edhe shkencarisht që edukimi parafillor është shumë I rëndesishëm në sistemin arsimor, parimisht jemi për dhe jemi duke punu që me rrit numrin e fëmijëve pjesmarrës në qerdhe ose në edukimin parafillor sigurisht që kjo don kohë por ne besoj që në baz të dinamikës sepse siq e dini qeveria ka premtu një nume të madh të qerdheve dhe realizimi është I vogël në raport me premtimet në baz të dinamikës e kom pa që e kan marr ma seriozisht edhe jan duke punu po shpresoj që kem me I pa në aspektin konkret që kto tri qerdhe që te hapen deri në vitin e ardhshëm

Mehedin Salihu-faleminderit kryesues me sa unë e kom kuptu nuk është qështja për qerdhe shtetore sepse te qerdhet shtetore disa kategori jan të lirune dhe të ndihmune propozimi I koleges është për qerdhet private për fëmijë që jan në institucione private kështu që mos të dalim prej kontesti nuk është ndonjë problem I madh drejtor se nuk kem shumë qerdhe private dy ose tri edhe ata besoj I kan shenimet nuk është ndonjë procedur e vështir këtu deshta me ndëhry që fjala është veq për fëmijët që vijojn në qerdhet private, faleminderit

Labinot Halilaj –Ta votojm në parim edhe vazhdojm procedurat, në procedura bashkarisht edhe florentina edhe të tjerët e dhëjn kontributin e vet kur të vijm me propozim final atëher e dim ku jem

Mehdin Salihu- Ne jemi duke e ba një vazhdim të mbledhjës së kalume dy ose tri pika që si kemi shqyrtu nuk jem duke e votu propozimin e Florentinës na jem veq në vazhdim të mbledhejes ama propozimi I florentinës e që ajo është ajo present ka qen për fëmijët që vijojn në qerdhe private edhe unë e kom arsyetu me arsyetimin se qerdhet shtetore I kan disa lirime për disa kategori, nëse ata jan të lirm në qerdhe publike në mirkuptim tu ndihmojm këtyre që nuk po munden në qerdhe private.

Milaim Hajdari- Të gjithë po pajtohem po flasim njejtë po në mënyra të ndryshme, atëher po votojm në parim ndërsa I mbetet drejtorit të financave, drejtorit të arsimit dhe Florentina Elezit me kontaktin kur të bëhet një propozim vendim ndoshta shkon një muaj ose dy nvalet domethan ki me qen në dieni

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hodhi në votim si parim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 25 aëntar, 25 votunan “Për”, kundër nuk pati, abstenim nuk pati, u miratua kjo pikë e rendit të ditës në parim.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e dhjetë të rendit të ditës: **10. Të ndryshme.**

Beqir Kiqina- Sa i përket pikës të ndryshme kisha dasht me ba një kërkesë drejtuar drejtoris së Ekonomis ditëve të fundit më kan kontaktuar biznese të vogëla dhe të mëdha edhe të mëdha disa prej tyre që operojn në Komunën e Drenasit dhe kërkese të tyre legjitime dhe konkrete ka qen që e diela të jet dit pushimi duke u bazuar në rregulloret ekonomike edhe legjislacioni në fuqi presedane të tilla kemi edhe në komuna të tjera si përshembull në mandatin e kaluar Komuna e Mitrovices ka bër një veprim të till andaj e lus drejtorinb e Ekonomis Drejtoreshen znj.Bucolli që të mërr masa dhe të përgadit për seancën e radhës një propozim vendim që të shqyrtojm së bashku si asamble por komform rregullores duke e ditur që ne jemi për bizneset por pasi që edhe bizneset janë për që e diela të mbetet dit pushimi edhe ashtu është të rregullohet në një normative dhe të bëhet me rrotacion përshembull ditën e diel të punojn disa biznese të cilat bëhen në bazë të një rregullore që e nxjerr Kuvendi Komunal po duke qen në bashkvendim dhe duke në kordinim të plot edhe me Ministrin e Ekonomis ajo rregullore I përshtatet kërkesave e kasha lut edhe drejtoreshen në fjal por edhe ekzekutivin kushdo nga ta por edhe kuvendin që një dit të bëjm një dëgjim publik së bashku me bizneset të cilat e kan ba kët kërkes dhe të hartojm një rregullore se si të veprohet ditëve të vikendit e sidomos të dielen.

Agnesë Kastrati Bucolli-Drejtoreshë e zhvillimit Ekonomik, Pasi i përshendeti të pranishmit sipas rregullores komunale nuk përcaktohet që të gjirha bizneset ditën e diel ta ken pushim në bazë të nenit ndahen në sektore gjithashtu përcaktohet edhe orari I punës gjat dtëve të festave edhe zgjatja e orarit, unë gjat javës së kaluar kasha një takim me asociacionin e komunave ku si tem diskutimi ishte edhe kjo që ditën e diel të ken bizneset pushimi mirëpo në baz të përvojes që komuna po e ceki e Gjilanit e Mitrovices që e kishin provu than që nuk ka pas sukses domethan disa jav ka fillu me u respektu rregullorja po pas disa muajve të gjithë kanë vazhdu me punu kështu që ne si drejtori ende nuk kemi pasur ndonjë kerkes prej bizneseve me shkrim por nese bizneset jan të interesuar ne mundemi me ba një kërkesë me mbajt një debat publik me bizneset edhe mundemi me marr parasysh kërkesat e tyre.

Beqir Kiqina – Faleminderit Kryesuese, faleminderit drejtoresh e ekonomis lidhur me bisedën paraprake që kemi diskutu lidhur me këtë temë po edhe sot si propozim konkret unë thash që të bëhen normative në bazë të një rregullore dhe jo për të gjitha bizneset të ndërpriten ditën e diel por të bëhet me rrotacion qoftë gastronomia, marketet në qoftë edhe ndonjë veprimtari tjetër ekonomike por ato të bëhen me orarë ngjajshëm sikurse barnatoret që punojnë me orar të caktuar për të dielën kjo është kërkesë eksplicite e vet bizneseve nëse ato bëjnë kërkesë dhe nësi përfaqësues e shtrojmë këtu dhe ju si ekzekutiv punoni e bëni një propozim vendim në e votojmë në atëherë në bazë të kësaj kërkesë dhe në bazë të rregullorës kemi të drejtë edhe mi gjobit ata të cilët e shkenil rendin dhe e shkelin vetveten sepse kërkesa është eksplicite dhe e drejtperdrejtë nga bizneset e komunës së Drenasit dhe të gjithë e dimë që e diela është ditë pushimi dhe po mendoj që është mirë me u bërë një normative e tillë edhe me u respektu po normal që duhet me qarkullu edhe të dielën por jo të gjitha për në bazë të rregullorës edhe në disa komuna që e praktikojnë disa ndoshta kanë pa telashe për të tjerat jo faleminderit

Egzona Tërdevci- Unë jam këtu për ta lexu një peticion të qytetarëve të Drenasit përkatsisht lagjes Drenasi I rruga Selman Demiqi Glllogoc ky peticion është dorëzuar shumë më herët në Komunën e Drenasit më 08.12.2022 I është drejtuar Kryetari të Komunës drejtoris së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapsiror, drejtoris së Shërbimeve Publike dhe drejtoris së Inspektoriatit përkatsisht inspektoriatit të ndërtimit kushdo që mundet me u përgjigjet le të përgjigjet nuk po e lexoj krejt peticionin supozoj që e keni po e lexoj vetëm të fundit është I nënshkruar prej 32 qytetarëve të kësaj lagje, peticion me qëllim të komunës së Glllogocit dhe drejtorive përkatese të saj se në lokacionin gjagjja e sipërshënuar pra lagjja Selman Demiqi në të cilën është realizuar projekti I shtëpive banimore të pronarëve privat I tipit të ndërtimit të ulët të gjitha të realizuara sipas lejeve për ndërtim dhe kushteve urbanistike të lejuara nga Komuna e Glllogocit tani në dy parcela me sipërfaqe të vogël ka filluar një projekt për ndërtim të lartë në të cilin janë vendosur reklamat për ndërtim të lartë pa përfillje të asnjë kriteri urbanistik e ligjor dhe janë sjellë makineria e rëndë për fillimin e punimeve ku nësi banor prekemi direkt nga ndërtimi I këti objekti dhe bllokimi I tërsishëm I kësaj lagje dhe pjesa e fundit andaj me qëllim të parandalimit të këti projekti dhe mos cenimit të të drejtave pronore banimore e funksionale të banorëve të shtëpive të ndërtimit të ulët dhe degradimit të kësaj lagje pjesët e qytetit kërkojmë që të merret parasysh ky peticion dhe nga organet kompetente të përgjegjshme ligjore të Komunës së Glllogocit që të inspektohet kjo zonë dhe të merren masat të parapara ligjore sipas ligjeve në fuqi, për këtë nësi poshtshënuarit e këti peticioni kërkojmë që kërkesa e jonë të trajtohet me kujdes dhe profesionalizëm dhe në pajtim me ligjet në fuqi nësi kundërtën jemi të detyruar të inicijmë edhe procedura tjera ligjore, sipas informative gjithëherë që unë i kam nga dorzuesit e peticionit ky peticion është dorëzuar më datën 08.12.2022 dhe as nuk kanë marrë përgjigje nga Komuna e Drenasit e as nuk ka pas inspektim faleminderit.

Petrit Gashi- Është e vërtetë një peticion prej 32 antarëve të cilët janë prej 2 familjeve mirëpo ju e dini se në zonën për të cilën po flasim në rrugën Selman Demiqi ju këtune keni votu vetë pra në bazë të hartave të reja zonale është zonë e ndërtimit të lartë dhe janë të parashikuara edhe në planin rregullativ po edhe në planin urbanistik të gjitha kushtet të cilat i plotson objekti në fjalë pra të gjitha kushtet aty keni qasje në dokumente zyrtare mundëni me i kërku të gjitha gjithashtu ministria atyne ju ka dhënë një përgjigje që gjithëqka është në rregull në lidhje me atë objekt dhe me inspektimet që janë bërë për gjatë rrugës shqetësimet e qytetarëve gjithëmonë janë të mirëpritura te na dhe ne ju japim shpjegime megjithatë tashë Drenasi po zhvillohet në kuadër të këti zhvillimi normalisht që po zgjerohen edhe zonat e ndërtimit të larta pjesa ku po flasim është pjesë e ndërtimit të lartë që hyn në kategorinë e parë

pra të qytetit dhe për këtë arsye normalishtë disa vendbanime ose disa familje të cilët kanë ndërtim të ulët kanë edhe shqetësimet e tyre, megjithatë sa i përket ndërtimit e inspektimit gjithashtu kushteve urbanistike dhe lejes së ndërtimit që ka operatori në fjalë gjithëqka është në rregull dhe këtë konfirmim familja e ka marrë edhe prej ministris.

Egzona Tërdevci- Faleminderit Drejtor për korrektësi në kemi votu kundër hartave zonale arsyet i kemi cek edhe atëherë nuk ka nevojë ti përseris unë nuk e mora përgjigjen se a ka pas inspektim prej drejtoris së inspektoriatit nëse ka pas inspektim gjithëherë sipas juve a është gjithëqka në rregull nëse është gjithëqka në rregull pse nuk I është kthyer përgjigja banorve nuk vlej shqetësimet e tyre edhe gjithëqka është në rregull

Petrit Gashi-Për të gjithë këtu dhe për të gjithë qytetaret e Komunës së Drenasit normalishtë që ka pas inspektim në i kemi fazat e inspektimit për çdo objekt I kategoris së ndërtimit të lartë prej fazes fillestare deri në fazën finale dhe pranimi teknik gjithashtu edhe për kushtet ndërtimore pengesat në rrugë levizja e lirë e qytetarëve levizja e lirë e makinave megjithatë sa I përket përgjigjes nuk është e vertetë në kemi kthyer përgjigjet madje I kemi I kemi kthyer edhe përgjigjen e dytë para dy ose tri ditë që ka kërkuar njëri nga përfaqësuesve të tyre dhe ajo përgjigje nuk ka zgjat më shumë se 24 orë dhe pra më shumë 24 orë në I kemi kthyer emailin dhe I kemi njoftuar edhe ata edhe ministrin në lidhje me zhvillimet që po bëhen në atë pjesë pra kemi zotime edhe prej operatorit në fjalë sepse shqetësimet e tyre kanë qenë me levizjen e lirë të qytetarëve dhe të makinave megjithatë në bazë të projektit të Komunës, hartave të reja zonale ajo zonë parashikohet zgjerimi I rrugëve, ndërtimi I trotuarëve dhe gjithashtu ndërtimi I zonave të larta në ato pjesë

Mehedin Salihu – Kam dy pyetje njëra është për Drejtorinë e Shëndetësisë po nuk qenka drejtoresha këtu dhe për Drejtorinë e Infrastruktura sa i përket drejtoris së Shëndetësisë pyetja ka të bëjë me shpalljen e një konkursi që ka qenë në QKMF, deshta të diskutoj rreth përzgjedhjes së kandidatëve, unë kam një listë me nënshkrime të njerëzve të pakënaqur duke filluar prej përzgjedhjes, prej formulimit të pyetjeve meqëse nuk është drejtoresha këtu unë po shfletoj në përgjisi edhe aty jam i pakënaqur edhe unë, të nderuar koleg në këtë konkurs janë përzgjedhur njerëzit të cilët vitin e kaluar e kanë kryer shkollën domethënë janë ndihmës infermieri e nuk është marrë infermieri ose ajo njeri që e ka masterin e infermieris nëse ne vazhdojmë ti injorojmë njerëzit që i kanë kryer fakultetet e mastera atëherë i demotivojmë edhe nuk ju jepim vullnet për më vazhdu për më vazhdu fakultetet edhe për më u zhvillu në aspektin profesional, ose shtrohet pyetja më konkret a është e mundur me dhënë provimin pranues një ndihmës infermieri e më pas me dhënë një njeri që ligjeron te atë infermier ose te atë nxënëse, unë këtë paknaqësi të këtyre edhe e përkrahi sepse shumë njerëz të mirë kanë mbetur jashtë dhe kërkojnë që herave tjera edhe të formulimi i pyetjeve komisioni ka bërë pyetje të cilat nuk i takojnë sektorit të infermieris atë që kanë qenë present këtu ka qenë edhe një asambleiste e cila mundet më ndihmu edhe me vertetë që shumë pyetje korrespondent për profesionin që e kanë pas, kërkojnë që herave tjera të jemi më vëmendshëm mos të lëmë njerëzit që kanë kryer shkollën atyherë unë nuk e kam dëgjuar e këtyre njerëzve se këta njerëz kanë me i marrë klinikën në QKUK në Prishtinë kanë me i marrë edhe qendra tjera private e shteti jashtëm e qendrat e jashtëme spitalore po ku po jemi nëse ne e marrim një njeri që e ka përfunduar shkollën vitin e kaluar e lëmë një njeri që është tuj prit që 10 vite nuk është fër për ne pamarrë parasysh kush është ai, janë mbetur njerëzit të cilët kanë kontribuar edhe në pandemi edhe në situatë të caktuara është dashur me pas njëfarë mirkuptimi për këta njerëz që kanë kontribuar kaq kasha sa i përket shëndetësisë, për drejtorinë e infrastrukture e kam një ankesë të një qytetari në fshatin Shtuticë I cili thotë se e kam bërë me shkrim nakesën ndoshta do ta marrë përgjigjen me shkrim sepse aty vazhdimisht rrjedhin ujrat rruga që është e asfaltuar gjithëmonë dëmtohet sidomos dimrit po edhe verës dëmtohet.

Arben Shala Nënkyetari i Komunës– i nderuar kan qenë gjithsej 249 aplikues sa i përket konkursit, konkursi i ka pas ato kriteret e parapara pytjet sigurisht jan hartu nuk e di kush I ka hartu sigurisht është komisioni profesional që i harton pytjet kur tham i kan marr të vitit që kan diploma rishtas e ata të mahershmit jo njëfar mënyre paragjykoni ata njerëz ne nuk guxojm të lëshohemi në aso paragjykimesh sigurisht i kan pas ndoshta edhe më te freskët ligjeratat se sapo i kan përfundu ligjeratat nuk guxojm me paragjyku i kemi pas gjithësej 7 ankesa ne qoftë se pajtoni me ata persona që kanë ba ankesa ne mundemi me i shiku edhe publikisht pergjigjet e tyre që kan pas në test pytjet i ka hartu komisioni përkatës adekuat faleminderit.

Muhedin Salihu- nënkryetar unë e kuptoj që ashtu duhet me thanë ti vet je një kuadër akademik edhe ti vet nuk ndihesh mirë nëse një nxënës i joti merret në punë e ti jo qfar niveli është aj komision që nuk e pranon atë që është më master të infermieris qysh e ndien veten aj komision që gjoja aj provimin e paska dhan ti vet je kuadër qysh ishe ndi ti në këtë rast edhe nuk është ashtu qysh po thu ti paragjykim po është fakt njerëzit e kan kry vitin shkollor vitin e kalun kem njerëz që pop resin që 10 vite për punë, duhet me pas mirëkuptim për këta njerëz duhet me ekzistitu një list e pritjes me ka edhe publikimin e rezultateve në list me pa sa pik i kan jo me ngajt nëpër zyre për me dit ku kanë gabu, unë nuk i paragjykoj i përkrahi se ata kan me punu edhe me mua veq bindu që duhet me pas respect për njerëzit qe kan përfundu më herët, përgaditje profesionale, që kan kontribu

Valentina Leku Gashi - Unë deshta me ban ë pytje për drejtorin e Shërbimeve Publike, Ministria e Financave Punës dhe Ttransfereve ka njoftu se ka fillu me angazhimin e ekipeve mobile për qëllim të lajmrimin të pensionistëve në dhe mbi moshen 85 vjeqare nëpër shtëpit dhe banesat e tyre në regjionin e Prishtinës ky shërbim ka fillu të zbatohet në Komunën e Prishtinës, Fushë Kosovës, Drenasit dhe tjera vende, pytja ime është a po zbatohet ky shërbim në Drenas kom pas disa ankesa për disa pensionist që janë të sëmur të shtrir që nuk mundën me ardh në qendën e lajmrimin ndërsa ekipet prej Drenasit nuk kan shku me I vazhdu pensionet, deshta me dit a është dukë u zbatu ky shërbim ne Drenas a duhet ata pavarisist veshtirsive me ardhë këtu, nuk kom shku në qendrën e lajmrimin po do të shkoj edhe atje, po deshta fillimisht me pyt këtu se kom pas ankesa prej disa pensionistëve sidomos prej atyre që I kan mbi 80 vjet e shumë të sëmur që jan detyru patjetër me ardh në Drenas me vazhdu pensionin që ky ekip nuk ka shku me I vizitu nëpër shtëpi.

Hamit Haxhiu – Shkolla Filllore “Rasim Kiqina” është qe më tepër se dy muaj e gjysmë që nuk ka mësimdhënës të Tikut, unë e kamë shqetësimin e prindërve këtu që më shqetëson se shumë është një periudhë që nuk e mbajnë atë lënd të cilët e kan në oear të tyre pytja ime për drejtorin është se deri kur do të plotësohet ajë vendë që është për mësimdhënës të Tikut.

Meqë nuk pati diskutime tjera kryesuesi e konsideroj të mbyllur seancën, seanca përfundoj rreth orës 11:40 min.

Me gjerësisht, mbledhjen e rregullt të Kuvendit të Komunës së Drenasit të datës 26.05.2023 dhe vazhdimin e mbledhjes të mbajur më datën 31.05.2023 mund të ndiqni në ueb faqen zyrtare të komunës, rrjetin social të Facebook dhe në kanalitn YouTube.

Procesmbajtëse:

Liridona Fejza-Ajazi

Erlona Gashi

Indira Olluri Thaqi



Kryesuesi i Kuvendit Komunal

Milaim Hajdari